**Republika e Kosovës/ Republika Kosova /Republic of Kosovo**

***Qeveria/Vlada/Government***

**Ministria e Punëve të Brendshme/**

**Ministarstvo Unutrasnjih Poslova/**

**Ministry of Internal Affairs**

Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz/

Nacijonalni Organ protiv Trgovine Ljudima/

National Authority against Trafficking in Human Beings

# STRATEGJIA KOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË KOSOVË

# 2015-2019

**Prishtinë, Mars 2015**

## Përmbajtja


LISTA E SHKURTESAVE ........ 3

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ........ 5

II. HYRJE ........ 8

III. METODOLOGJIA ........ 9

IV. SFONDI ........ 10

- ANALIZA E GJENDJES AKTUALE ........ 10
- MASAT E NDËRMARRA NË LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ........ 11
- MBROJTJA E VIKTIMAVE ........ 13
- MASAT PARANDALUESE ........ 14

V. KUADRI STRATEGJIK ........ 15

- A. VIZIONI ........ 15
- B. DEKLARATA E MISIONIT ........ 15
- C. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE ........ 15

VI. IMPLEMENTIMI ........ 18

VII. QASJA E REKOMANDUAR ........ 19

VIII. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE ........ 20

- KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE ........ 20
- INSTRUMENTET E BASHKIMIT EVROPIAN ........ 21
- KORNIZA LIGJORE VENDORE ........ 21
- MEKANIZMAT OPERACIONAL ........ 22
- KORNIZA INSTITUCIONALE ........ 22

IX. FINANCIMI I STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT ........ 26

X. SHTOJCA 1 – PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË ........ 27

## Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| DHTQNj | Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit të Qenieve Njerëzore |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| DPMS | Drejtoritë e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| DMS | Departamenti i Mirëqenies Sociale |
| GIZ | Deutche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit |
| GPNM | Grupi Punues Ndër Ministror |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnim të Hetimeve Penale |
| IGjK | Instituti Gjyqësor i Kosovës |
| ILECU | Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatim të ligjit |
| ILO | Organizata Ndërkombëtare e Punës |
| IO | Organizatë Ndërkombëtare |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migracion |
| IPK | Inspektorati Policor i Kosovës |
| KGjK | Këshilli Gjyqësor i Kosovës |
| KNKT | Koordinatori Nacional për Kundër-Trafikim |
| KP | Policia e Kosovës |
| KPK | Këshilli Prokurorial i Kosovës |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MTR | Mekanizmi Transnacional i Referimit |
| M&V | Mbikëqyrja dhe Vlerësimi |
| OJQ | Organizatë Joqeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| QMVPT | Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit |

| | |
|---|---|
| PSH | Prokurori Shtetëror |
| PSV | Procedurat Standarde të Veprimit |
| RAE | Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptasit |
| SDSF | Shpresë dhe shtëpi për fëmijët (Hope and Homes for Children) |
| SKT | Sekretariati Kundër Trafikimit me njerëz |
| SNPV | Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit |
| SMKVT | Standardet minimale për kujdesit për viktimat e trafikimit |
| SPS | Strehimorja e Përkohshme e Sigurt |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| TDH | Terre des Hommes |
| TNj | Trafikimi me Njerëz |
| TEIP | Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| VPT | Viktimat Potenciale të Trafikimit |
| VT | Viktimat e Trafikimit |
| ZBE | Zyra e Bashkimit Evropian |
| ZK | Zyra e Kryeministrit |
| ZMNV | Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave |

## I. Përmbledhje Ekzekutive

Fenomeni i Krimit të Organizuar ngërthen në vete një mori sfidash për shoqërinë Kosovare në përgjithësi si dhe për mekanizmat e shtetit në veçanti. Në njërën anë Krimi i Organizuar është aktivitet fitim-prurës për kriminelët por në anën tjetër është një ndër sfidat kryesore për shtetin dhe shoqërinë tonë. Si formë e veçantë e krimit të organizuar, trafikimi me njerëz si njëra ndër format e skllavërisë moderne paraqet kërcënim për shoqërinë kosovare duke pasur parasysh sidomos trendet e fundit në rritje të numrit të viktimave vendore. Ky trend është në rritje që nga viti 2005, sidomos në vitet e fundit që njëherësh paraqet sfidë për tërë sistemin vendor kundër trafikimin me njerëz.

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz është dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat që duhen ndërmarr kundër këtij fenomeni negativ. Ky dokument strategjik, që rrjedh nga prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specifike të përcaktuara qartë nga ana cilësore dhe sasiore të cilat janë të bazuara mbi masat publike dhe aktiviteteve për t'u mbështetur në mënyrë institucionale dhe financiare, dhe të cilat mund të verifikohen nëpërmjet një monitorimi të detajuar dhe të procesit të vlerësimit.

Qasja strategjike e cila është ndërtuar për luftimin e trafikimit me njerëz është bazuar në përvojën e deritanishme, përkatësisht politikat e ndërmarra nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe vlerësimin Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz 2011 - 2014. Në mënyrë që të ndërtohet një vizion afatgjatë për luftimin e kësaj dukurie, hartimi i kësaj strategjie është bazuar gjithashtu në politika të avancuara të Bashkimit Evropian, si dhe agjenci të tjera ndërkombëtare të cilat trajtojnë këtë fushë.

Qëllimi i kësaj strategjie dhe plani të veprimit është që të fuqizoj përpjekjet institucionale dhe të tërë shoqërisë Kosovare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, gjithmonë duke marr parasysh rekomandimet që dalin nga raportet e organizatave ndërkombëtare, raportet e Komisionit Evropian si dhe partnerëve vendor dhe ndërkombëtar nga sektori privat dhe shoqërisë civile, me qëllim dhe synim të përbashkët, atij parandalimit, luftimit dhe rrënjosjes së fenomeneve kriminale si ato të trafikimit me njerëz, të cilat cenojnë shoqërinë Kosovare, fqinjët tanë si dhe shumë vende të botës.

Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz reflekton objektivat strategjike në përputhje të plotë me Strategjinë e BE-së për Çrrënjosjen e Trafikimit me Njerëz 2012-2016 të qershorit 2012 dhe me adresim të problematikës në kontekst vendor dhe rajonal. Rrjedhimisht objektivat dhe masat e paraparë në këto dokumente strategjike bëjnë ndërlidhjen me 5 (pesë) prioritetet e BE-së për adresimin e çështjes së trafikimit me njerëz. Këto prioritete janë si në vijim:

1. Identifikimi, mbrojtja dhe asistimi i viktimave të trafikimit;
2. Intensifikimi i parandalimit të trafikimit me njerëz;
3. Rritja e ndjekjeve penale ndaj trafikuesve;

4. Përforcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve kyçë dhe koherencës së politikave;
5. Rritja e njohurive dhe reagimit të efektshëm për shqetësimet e reja që lidhen me të gjitha format e trafikimit me njerëz.

Strategjia ofron kornizë legjislative dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, duke definuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve në përputhje me objektivat e strategjisë. Ky dokument strategjik reflekton mbi gjendjen ekzistuese, trendet dhe politikat e ndërmarra në nivel rajonal dhe Evropian duke ofruar objektiva strategjike si dhe masa konkrete të cilat janë të arritshme në aspektin buxhetor, resurseve njerëzore dhe siguron koherencë të zhvillimit dhe zbatimit të politikave strategjike në nivel vendi.

Kjo strategji përbëhet në dy pjesë kryesore, përkatësisht nga dokumenti strategjik dhe plani i veprimit për zbatimin e strategjisë që i bashkëngjitet si shtojcë. Strategjia është e strukturuar në 7 kapituj duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012[1], i cili përcakton kriteret për inicimin, hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike.

Në pjesën hyrëse të strategjisë janë paraqitur aspekte të ndërlidhjes së kësaj strategjie me prioritetet e Qeverisë dhe nevojën për hartimin e saj. Një pjesën metodologjike pasqyrohen ministritë dhe institucionet kryesore të përfshira në hartimin e dokumentit, si dhe rolin organizatave ndërkombëtare ose organizatave të shoqërisë civile në hartimin e tij. Kjo pjesë gjithashtu paraqet qasjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë këta akterë, dhe akterët të cilët janë konsultuar gjatë procesit të hartimit.

Pjesa analitike e strategjisë përmban vlerësime të gjendjes aktuale të trafikimit me njerëz në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në raportet e vlerësimit të Strategjisë 2011-2014, raporte të Komisionit Evropian, Departamentit të Shtetit, si dhe organizatave të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Kjo pjesë është hartuar gjithashtu përmes konsultimeve të drejtpërdrejta me të gjithë akterët përkatës të përfshirë në fushën e luftimit, parandalimit, identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz.

Vizioni i ndërtuar në kuadër të kësaj strategjie synon adresimin e problemeve të shumta me të cilat shoqëria jonë, por edhe e vendeve të tjera ballafaqohen, ku trajtimi çnjerëzor i viktimave të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual por edhe qëllime të tjera janë shtuar në vazhdimësi. Kjo strategji synon të përmirësoj mjedisin ligjor dhe institucional, fuqizoj bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit, ndjekjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Duke zbatuar këtë vizion ne do të kemi një shoqëri ku trafikimi me njerëz do të mbetet pjesë e së kaluarës dhe se Kosova do të jetë një vend me siguri të lartë njerëzor, me emancipim të lartë gjinor dhe shoqëri gjithëpërfshirëse.

Qëllimi kryesor i strategjisë do të jetë ***Koordinimi i veprimeve parandaluese dhe luftës kundër trafikimit me njerëz me qëllim të zvogëlimit të rasteve të trafikimit në Kosovë deri në minimum si dhe koordinimi për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktima të trafikimit duke synuar kthimin e dinjitetit të tyre dhe duke parandaluar ri-trafikimin e tyre.***

[1] Udhëzimi Administrativ 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe hartimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre: http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Udhezimi_Administrativ_Per_Strategjite_FINAL_2012__2_.pdf

Kuadri strategjik është hartuar duke u bazuar në analizat dhe vlerësimet e gjendjes aktuale dhe nevojat për adresimin e problemeve përkatëse në këtë fushë. Duke u bazuar në konsensusin e të gjitha institucioneve pjesëmarrëse në procesin e hartimit të strategjisë, Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëzor 2015-2019 përbëhet nga 4 objektiva strategjike:

1. *Avancimi i parandalimit të trafikimit me njerëz përmes informimit, vetëdijesimit dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi, dhe grupeve të cenueshme në veçanti për pasojat e trafikimit dhe përfshirjes në aktivitete të trafikimit*
2. *Fuqizimi i vazhdueshëm i sistemit të identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit përmes programeve të qëndrueshme të përfshirjes sociale*
3. *Ndjekje penale efikase të rasteve të trafikimit me njerëz përmes ngritjes së efikasitetit të mekanizmave për zbulimin dhe ndjekjen e trafikuesve*
4. *Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar për një partneritet të fuqizuar ndaj trafikimit me njerëz*

## II. Hyrje

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz 2015-2019 është një obligim që rrjedh nga prioritetet që kanë përcaktuar institucionet e Republikës së Kosovës, për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar dhe të gjitha format e shfaqjes së tij. Trafikimi me njerëz është një dukuri shqetësuese për më shumë se një dekadë në Kosovë, dukuri e cila ka evoluuar dhe ndryshuar në format dhe trendet e saja.

Institucionet e Republikës së Kosovës janë duke trajtuar trafikimin në njerëz më shumë seriozitet dhe përkushtim. Në fillim fokusi kryesor ishte krijimi i strukturave të qëndrueshme dhe mekanizmave që e luftojnë trafikimin në njerëz me efektivitet si dhe sigurimi i shërbimeve për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Më pas fokus ishte lehtësimi i punës së këtyre mekanizmave përmes përmirësimit të bazës ligjore dhe politikave efikase në luftimin e suksesshëm të trafikimit. Me të gjitha mekanizmat e krijuara, mbështetur dhe lehtësuar nga baza e mirë ligjore dhe politikave tjera, mbetet që me këtë Strategji Kombëtare të punohet në funksionalizimin e mëtutjeshëm të tërë këtij mekanizmi. Kjo synohet të arrihet fillimisht me qëllim të parandalimit të trafikimit, e më pas edhe në hetimin dhe përndjekjen e trafikuesve, ofrimin e shërbimeve kualitative dhe të dinjitetshme për viktimat e trafikimit si dhe përmirësimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në luftimin e kësaj dukurie.

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz është në përputhje të plotë me dokumentet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me reformat që janë duke u ndërmarr në kontekst të procesit të integrimit Evropian si dhe dialogut për liberalizim të vizave me Bashkimin Evropian si dhe nga obligimet tjera ndërkombëtare. Programi i Qeverisë 2011-2014 ka paraparë luftimin dhe uljen e shkallës së kriminalitetit, ndër të tjera përmes fuqizimit të kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar e në veçanti atij të trafikimit me njerëz. Prioritet tjetër në kuadër të programit të qeverisë është fuqizimi i bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe ato Evropiane si dhe me mekanizmat ndërkombëtar dhe Evropian për zbatim të ligjit me qëllim të harmonizimit të veprimeve dhe sigurimit të qasjes uniforme në adresimin e problemit të trafikimit me njerëz.

Në të njëjtën mënyrë kjo fushë trajtohet edhe nga dokumente tjera strategjike, si: Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016, dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve; Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim; dhe Plani Vjetor i Punës së Qeverisë. Hartimi i Strategjisë gjithashtu është bërë në përpushmëni të plotë me Strategjinë e Bashkimin Evropian për çrrënjosjen e trafikimit me njerëz 2012 – 2016.

Strategjia gjithashtu është bazuar në Ligjin  për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i cili trajton të gjitha format e trafikimit me njerëz, qoftë kombëtar, ose trans-nacional dhe pavarësisht se a lidhet a jo me krimin e organizuar, duke përfshirë veprat e kryera për qëllime të shfrytëzimit të viktimave përderisa ato përmbajnë elementet e trafikimit me njerëz.

## III. Metodologjia

Hartimit të Strategjisë Kombëtarë kundër Trafikimit me Njerëz 2015-2019 i ka paraprirë vlerësimi gjithëpërfshirës lidhur me zbatueshmërinë e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2011-2014. Po ashtu janë analizuar në detaje të gjitha raportet e mekanizmave relevant ndërkombëtar si Departamentit Amerikan të Shtetit, Komisionit Evropian, OSBE-së, shoqërisë civile etj.

Procesi i hartimit të strategjisë është koordinuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit. Grupi Punues ndër-ministror, partnerët ndërkombëtar, shoqëria civile dhe grupet tjera të interesit janë përfshirë në vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të zbatimit të strategjisë kundër trafikimit me njerëz 2011-2014 (Shtojca II – Akterët e përfshirë në hartimin e Strategjisë). Grupi punues ka punuar në analizimin e gjendjes aktuale, identifikimin e sfidave që duhet adresuar me këtë strategji dhe duke propozuar objektiva dhe masa të cilat do të përmirësojnë efikasitetin e institucioneve të përfshira në zbatim me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz, gjithmonë duke qenë të vetëdijshëm për aspektin trans-nacional që ky fenomen ngërthen.

Në procesin e hartimit janë angazhuar ekspert vendor me qëllim të lehtësimit të procesit të vlerësimit të gjendjes aktuale si dhe hartimit të dokumentit. Në këtë kuadër një kontribut të veçantë kanë dhënë Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (GIZ). Kjo e fundit ka përkrahur Zyrën e Koordinatorit Kombëtar përmes sigurimit të fondeve për të hartuar draftin përfundimtar të strategjisë.

# IV. Sfondi

## Analiza e gjendjes aktuale

Trafikimi i njerëzve është shkelje e të drejtave të njeriut të personave të prekur dhe kjo është një nga format më agresive të krimit të organizuar, e cila përpiqet të cenojë shoqërinë e Kosovës. Dinjiteti njerëzor radhitet si një nga vlerat themelore njerëzore në aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës janë përkushtuar të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme pozitive për të garantuar këtë vlerë në mënyrë efektive dhe përveç kësaj, të mbrojnë popullin e Kosovës nga fenomeni negativ i trafikimit të njerëzve dhe njëkohësisht të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e njeriut për të gjitha viktimat e trafikimit, pa marrë parasysh racën, kombësinë ose gjininë.

Trafikimi me njerëz përbën krim serioz që shpesh ka implikime me të cilat shtetet nuk munden ti adresojnë individualisht. Si pasojë, trafikimi me njerëz rezulton të jetë një fenomen kompleks trans-nacional që i ka rrënjët në ndjeshmërinë ndaj varfërisë, mungesës së kulturave demokratike, pabarazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, konfliktit dhe situatave të pas konfliktit, mungesës e integrimit shoqëror, mungesës së mundësive dhe punësim, mungesës së qasjes në arsim, punës së fëmijëve dhe diskriminimit.[2]

Kosova ka qenë dikur vend i origjinës, destinacionit dhe transitit.[3] Ndërsa tashmë mbetet kryesisht vend i origjinës dhe transit për viktimat e trafikimit për qëllime të eksploatimit seksual dhe me një rritje në numër të viktimave të mitur.[4] Bazuar në të dhënat statistikore të Policisë së Kosovës, tendencat e trafikimit me njerëz në Kosovë tregojnë se ky fenomen kriminal është më i përqendruar në trafikimin e brendshëm (nga grupet kriminele përbrenda Kosovës) dhe si rezultat i kësaj kemi më shumë viktima vendore të trafikimit. Statistikat e viktimave të identifikuara të trafikimit janë tregues i rritjes së viktimave vendore të trafikimit, në veçanti që nga viti 2005 dhe ka kulminuar në vitin 2011 ku janë identifikuar 35 viktima Kosovare të trafikimit, përderisa viktimat me origjinë nga Moldavia, Ukraina, Rusia, Rumania, Bullgaria kanë pësuar rënie që nga viti 2007, me përjashtim të vitit 2012 ku janë identifikuar 22 viktima të trafikimit nga Moldavia.[5] Ky trend i viktimave të identifikuara të trafikimit ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013 ku në total janë identifikuar 52 viktima të trafikimit.

Grupet më të cenueshme ndaj trafikimit në njerëz janë femrat e sidomos fëmijët numri i të cilëve është rritur viteve të fundit. Shumica e rasteve janë të trafikuara me qëllim të shfrytëzimit seksual, mirëpo çdo vit e më shumë përqendrimi i institucioneve të Republikës së Kosovës është fokusuar edhe në identifikimin e formave të ndryshme të trafikimit, e sidomos ato që lidhen me shfrytëzimin e fëmijëve për lypësi dhe punë të detyruar. Raporti i Progresit 2013 për Kosovën nënvizon faktin që ‘trafikimi i fëmijëve dhe eksploatimi i fëmijëve për qëllime të lypësisë mbetet i lartë’.

---

2 Strategjia e BE-së drejt çrrënjosjes së Trafikimit me Njerëz 2012-2016.
3 Raporti i Progresit 2010 për Kosovën.
4 Raporti i Progresit për Kosovën, Tetor 2013, faqe 51.
5 Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, faqe 22.

Trafikimi me njerëz është në vetvete një dukuri komplekse dhe e vështirë për t'u marrë me të, kurse trafikantët gjithmonë përpiqen të gjejnë mënyra të reja për të vazhduar aktivitetin e tyre.

## Masat e ndërmarra në luftimin e trafikimit

Sipas raportit të progresit të Strategjisë Kombëtare kundër trafikimit me njerëz 2011-2014, përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për miratimin e legjislacionit në përputhshmëri me praktikat me të mira Evropiane dhe përkrahje e vazhdueshme e mekanizmave, sikurse strukturat kundër trafikimit në kuadër të MPB-së, si dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës të përfshira në zhvillimin dhe zbatimin e kornizës strategjike në këtë fushë tregon se janë bërë përpjekje të konsiderueshme. Agjenda e Qeverisë së Kosovës ndaj kësaj dukurie është zhvilluar nga perspektiva e të drejtave të njeriut, duke u bazuar në faktin se qasja e ndërtuar ndaj dukurisë së trafikimit me njerëzor është konsideruar si shkelje e të drejtave themelore të njeriut.[6]

Qeveria e Kosovës e konsideron trafikimin me njerëz edhe si fenomen global që duhet të adresohet me një qasje globale. Prandaj edhe me këtë Strategji, Qeveria e Kosovës do të vazhdoj në krijimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet tjera në luftimin e këtij fenomeni dhe do të vazhdoj të punoj në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen në mekanizmat ndërkombëtar që e luftojnë trafikimin e njerëzve, i cili pasqyrohet si eksploatim transnacional njerëzor. Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar protokollin për bashkëpunim në identifikimin, referimin dhe kthimin e lehtësuar vullnetar të viktimave të trafikimit me theks të veçantë në viktimat e trafikimit. Marrëveshje e tillë bashkëpunimi është nënshkruar edhe në mes të Kosovës dhe Malit të Zi me 25 Prill 2014.

Vlerësohet se bashkëpunimi ndërkombëtar është çelësi kryesor për luftimin e krimit të organizuar, dhe në këtë kuadër marrëveshjet e shumta të nënshkruara për bashkëpunimin me shtete të rajonit dhe të Evropës kanë dhënë rezultate të pritura. Bashkëpunimi strategjik dhe operacional në fushën e zbatimit të ligjit me vendet rajonit dhe vendet anëtare të BE-së funksionon gjithashtu në baza jo-formale. Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, ekzistojnë një numër i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende të ndryshme. ILECU ka vendosur një bazë të mirë të bashkëpunimit me vendet tjera si dhe institucione ndërkombëtare. Përkundër, nënshkrimit të disa marrëveshjeve për bashkëpunim me vendet individuale, mungesa e komunikimit të drejtpërdrejt institucione si INTERPOL dhe EUROPOL paraqesin pengesa për PK-në në luftimin formave të ndryshme të krimit.

Qeveria e Kosovës përmes mekanizmave përkatës institucional dhe me mbështetje të partnerëve ndërkombëtar dhe sektorit joqeveritar vendor ka bërë përparim të dukshëm në aspektet e kundër-trafikimit. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale që kanë hyrë në fuqi në Janar të vitit 2013 kanë ashpërsuar politikën ndëshkimore për trafikuesit, kanë penalizuar shfrytëzimin e shërbimeve të viktimave të trafikimit dhe kanë përfshirë lypjen e detyruar si vepër trafikimi. Më tej, Kosova është ndër vendet e pakta që ka një ligj të veçantë për parandalim dhe luftim të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit i cili ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 2013 dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave

[6] Raporti i Progresit i Strategjisë Kombëtare 2011-2014 për vitin 2013.

juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuara, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko-sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo kombësisë së tyre, përmes një qasje të bazuar në të drejta të njeriut dhe me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve.

Në aspektin e ndjekjes penale, Policia e Kosovës ka iniciuar 104 hetime të reja të natyrës së trafikimit gjatë vitit 2012, 100 raste i janë përcjellur Prokurorisë gjatë vitit 2012, ndërsa gjatë vitit 2013 Policia e Kosovës është marr me 71 raste të veprave penale të ndërlidhur me marrje me prostitucion, trafikim me njerëz dhe mundësim prostitucioni.




Burimi: Policia e Kosovës

Bazuar në statistikat e Policisë së Kosovës vërehet trendi në rritje i arrestimeve të personave të përfshirë në trafikim me njerëz, ku gjatë vitit 2011 janë arrestuar 183 persona, gjatë vitit 2012 janë arrestuar 223 persona dhe gjate vitit 2013 janë arrestuar 182 persona. Përderisa në vitin 2012 janë ndjekur penalisht 31 raste të reja krahasuar me 22 raste në vitin 2011.




Burimi: Policia e Kosovës

Gjithashtu vërehet një rritje e vogël sa i përket dënimeve të shqiptuara nga ana e gjykatave për trafikantët duke dënuar 41 prej tyre në vitin 2012 krahasuar me 37 prej tyre të dënuar në vitin 2011. Edhe përkundër faktit të rritjes së trendeve të ndjekjes dhe arrestimit të personave

dhe grupeve kriminale që merren me trafikim me njerëz, shkalla e dënimeve për rastet e trafikimit të fëmijëve dhe eksploatimit të fëmijëve për qëllime të lypësisë mbetet i ulët.[7] Trendet në rritje eksploatimit të fëmijëve për qëllime të lypësisë mbeten shqetësim për tërë rajonin, në veçanti për fëmijët nga Shqipëria të cilët shfrytëzohen për qëllime të lypësisë në Kosovë.

| Rastet e paraqitur në Zyrën e Prokurorit bazuar në veprat kriminale[8] | 2012 | 2013 |
|---|---|---|
| Trafikim me njerëz | 34 | 38 |
| Lehtësim i prostitucionit | 27 | 18 |
| Ushtrim i prostitucionit | 37 | 15 |
| Vepra të tjera kriminale | 4 | 17 |
| **Totali** | 102 | 88 |

## Mbrojtja e viktimave

Mbrojtja e viktimave të trafikimit mbetet një sfidë për institucionet e Republikës së Kosovës edhe përkundër faktit së është bërë një përparim në krijimin e kushteve të përshtatshme për ofrimin e masave të mbrojtjes, strehimit dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit. Bashkëpunimi dhe kontributi i organizatave të shoqërisë civile është i rëndësisë së veçantë, në veçanti ato të cilat ofrojnë shërbime të specializuara dhe ekspertizë në trajtimin e kësaj problematike të ndejshme. Qeveria e Republikës së Kosovës ka përkrah çështjet e mbrojtjes dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit dhe gjatë vitit 2012 ka ofruar mbështetje për 43 viktima të trafikimit, përderisa në vitin 2013 ka ofruar përkrahje për 52 viktima të trafikimit.

Një përparim i veçantë në lidhje me mbrojtjen e viktimave të trafikimit është edhe rishikimi i procedurave standarde të veprimit për të reflektuar ndryshimet e bëra në kodin e ri penal, në veçanti për zyrtarët policor dhe punonjësit social në lidhje me referimin e viktimave të trafikimit pas identifikimit të tyre. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë është duke hartuar Projekt-ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit me anë të të cilit do të funksionalizohet programi për kompensim të viktimave të krimit dhe i njëjti është në pajtim me Direktivën e Këshillit 2004/80/EC të 29 prillit 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit. Edhe përkundër përparimeve që janë bërë në kuadër të zbatimit të Strategjisë kundër Trafikimit me Njerëz 2011-2014 në aspektin e mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit, grupi punues ndër-ministror ka identifikuar çështjet dhe mangësitë që duhet adresuar me strategjinë 2015-2019 dhe që ndërlidhen përkitazi me konsolidimin e mekanizmave për identifikimin e viktimave të trafikimit si dhe si funksionalizimi i plotë i mekanizmave të referimit të viktimave dhe atyre për mbrojtje, asistim dhe ri-integrim.

[7] Raporti i Progresit 2013 për Kosovën, Tetor 2013.
[8] Raporti i Progresit 2013 për Strategjinë Kombëtare kundër trafikimit me njerëz 2011 - 2014

## Masat parandaluese

Masat parandaluese si fushatat mediale të informimit dhe vetëdijesimit, debatet e ndryshme që kanë për qëllim informimin e opinionit të gjerë, në veçanti për grupet e cenuara ndaj trafikimit, kanë qenë fokus i veçantë i zyrës së koordinatorit nacional kundër trafikimit me përkrahje të organizatave ndërkombëtare si OSBE, UNDP si dhe organizatave jo-qeveritare të cilat kanë dhënë një kontribut të veçantë. Nga raporti monitorues dhe vlerësues i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit kundër trafikimit me njerëz 2011-2014 del se 45.83% e aktiviteteve të parapara janë zbatuar apo janë duke u zbatuar përderisa 20.83 të aktiviteteve nuk kanë filluar ende së zbatuari. Kjo dëshmon faktin se Strategjia kundër Trafikimit me Njerëz 2015-2019 duhet të synoj të fuqizoj komponentin e parandalimin përmes aktiviteteve të informimit dhe vetëdijesimit dhe duke përfshirë më shumë akterët jashtë-institucional.

# V. Kuadri Strategjik

## A. Vizioni

- ***Një shoqëri ku trafikimi me njerëz është pjesë e të kaluarës***
- ***Kosova vend me siguri të lartë njerëzore, emancipim gjinor dhe shoqëri gjithëpërfshirëse***

## B. Deklarata e Misionit

***Koordinimi i veprimeve parandaluese dhe luftës kundër trafikimit me njerëz me qëllim të zvogëlimit të rasteve të trafikimit në Kosovë deri në minimum si dhe koordinimi për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktima të trafikimit duke synuar kthimin e dinjitetit të tyre dhe duke parandaluar ri-trafikimin e tyre***

## C. Objektivat Strategjike

### *Objektiva Strategjike 1*

***Avancimi i parandalimit të trafikimit me njerëz përmes informimit, vetëdijesimit dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi, dhe grupeve të cenueshme në veçanti për pasojat e trafikimit dhe përfshirjes në aktivitete të trafikimit***

### *Objektiva Strategjike 2*

***Fuqizimi i vazhdueshëm i sistemit të identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit përmes programeve të qëndrueshme të përfshirjes sociale***

### *Objektiva Strategjike 3*

***Ngritje e efikasitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit me njerëz përmes fuqizimit të mekanizmave për zbatim të ligjit***

### *Objektiva Strategjike 4*

***Fuqizim i bashkëpunimit dhe koordinimit  në nivel vendor dhe ndërkombëtar për parandalimin, ndjekjen, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit***

## D. Objektivat Specifike

Në këtë seksion do të paraqiten objektivat specifike të cilat janë paraparë për arritjen e objektivave strategjike në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër trafikimit me njerëz.

1. ***Avancimi i parandalimin të trafikimit me njerëz përmes informimit, vetëdijesimit dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi, dhe grupeve të cenueshme në veçanti për pasojat e trafikimit dhe përfshirjes në aktivitete të trafikimit***

### Objektivat Specifike

1.1. Vetëdijesimi, edukimi dhe informimi i gjithëmbarshëm për çështjen e trafikimit me njerëz, duke përfshirë sanksionet ligjore;
1.2. Plotësimi i kurikulave edukativo –arsimore me informacione shtesë për parandalimin e trafikimit me njerëz;
1.3. Përfshirja e grupeve të rrezikuara në arsimimin dhe edukimin joformal;
1.4. Vetëdijesimi i institucioneve mediatike për shtjellimin dhe adresimin e mirëfilltë të çështjes së trafikimit;
1.5. Ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile në parandalimin e trafikimit;

2. ***Fuqizimi i vazhdueshëm i sistemit të identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit përmes programeve të qëndrueshme të përfshirjes sociale***

### Objektivat specifike

2.1. Avancimi i metodologjisë për identifikimin dhe referimin e hershëm të personave në rrezik nga trafikimi;
2.2. Fuqizimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe afatgjatë për viktimat e trafikimit;
2.3. Sigurimi i zbatimit të legjislacionit për identifikimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit;
2.4. Të sigurohet qëndrueshmëria financiare për institucionet që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit;
2.5. Fuqizimi i shërbimeve riintegruese afatgjata

3. ***Ngritje e efikasitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit me njerëz përmes fuqizimit të mekanizmave për zbatim të ligjit***

### Objektivat specifike

3.1. Analiza e trafikimi me njerëz në nivel shtetëror për të identifikuar kërcënimet, trendet, problemet dhe rreziqet në fushën e trafikimit me njerëz;
3.2. Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatim të ligjit për hetim efikas të rasteve të trafikimit;
3.3. Ngritja e kapaciteteve për zbulimin e rasteve të trafikimit me njerëz;
3.4. Rritja e efikasitetit institucional në konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale;

3.5. Përmirësimi i sistemit prokurorial dhe gjyqësor në trajtimin me prioritet të rasteve të trafikimit me njerëz.

***4. Fuqizim i bashkëpunim dhe koordinimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar për parandalimin, ndjekjen, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit***

**Objektivat specifike**

4.1. Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional dhe me komunitet për parandalimin dhe referimin e rasteve të trafikimit me njerëz

4.2. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në të gjitha nivelet në fushën e mbrojtjes dhe riintegrimit

4.3. Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit;

4.4. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional

4.5. Harmonizimi i legjislacionit dhe ngritja e kapaciteteve konform standardeve të BE-së;

4.6. Anëtarësimi i institucioneve të Kosovës në mekanizma ndërkombëtar

## VI. Implementimi

Me qëllim të zbatimit të objektivave strategjike të cilat ndërlidhën me Identifikimin, mbrojtjen, asistimin dhe reintegrimin e viktimave, Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Strategjinë Legjislative 2014 ka finalizuar Projektligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit i cili mundëson krijimin e Programit për kompensim të viktimave të krimit dhe i njëjti është në pajtim me Direktivën e Këshillit 2004/80/EC të 29 prillit 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit. Miratimi dhe zbatimi i këtij Ligji do të garantoj qëndrueshmëri financiare për zbatim të politikave që synojnë mbrojtjen, asistimin dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit nga ana e institucioneve përgjegjëse për shërbime të ndryshme dhe do të ndikoj në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies institucionale karshi obligimeve që dalin nga kjo Strategji.

Në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore të bëra, në veçanti me miratimin e Ligjin e ri për parandalimin dhe luftimin e trafikimit në njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit i cili ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 2013 janë rishikuar edhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për viktimat e huaja dhe ato vendore dhe Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz 2015-2019 synon zbatimin e këtyre procedurave standarde të veprimit të rishikuara për të rritur efikasitetin e institucioneve dhe partnerëve tjerë në drejtim të referimit të viktimave të trafikimit, ofrimit të mbrojtjes, asistimit dhe kushteve më të përshtatshme për ri-integrim të qëndrueshëm si qëllim kryesore përfshirjen e viktimave të trafikimit në shoqëri dhe jetë normale dhe të dinjitetshme.

Një masë tjetër po aq e rëndësishme që kjo Strategji synon të arrij është edhe sigurimi i fondeve të qëndrueshme për financim të strehimoreve për viktimat e trafikimit. Në këtë drejtim, bashkëpunimi i ngushtë me sektorin jo-qeveritar paraqet kusht themelore për arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Përveç kornizës ligjore, institucionet qe merren drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimeve për viktima të trafikimit funksionojnë në bazë të mekanizmave operacional që janë fuqizuar me Ligjin e ri për parandalimin dhe luftimin e trafikimit në njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Këto dokumente janë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për viktimat e huaja dhe ato vendore (të rishikuara ne 2013) dhe Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit. Këto dy dokumente janë aprovuar dhe zbatohen në koordinim të plotë nga të gjithë akterët që merren me identifikimin, mbrojtjen, dhe referimin e viktimave të trafikimit me njerëz.

Programi i paraparë të themelohet me këtë Ligj përcakton të drejtën për kompensim, procedurat e përfitimit, autoritetet kompetente siç është Komisioni për Kompensimin e Viktimës së Krimit, pastaj procedurat e përfitimit në situata ndërkufitare, financimin e Programit kombëtar për kompensimin e viktimave të krimit etj.

Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të avancoj bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në luftimin e trafikimit me njerëz, në veçanti duke pas parasysh natyrën ndër-kufitare dhe trans-nacionale të krimit të organizuar dhe krimeve serioze të natyrës së trafikimit me njerëz. Në këtë drejtim Kosova ka nënshkruar protokollin për bashkëpunim në identifikimin, referimin dhe kthimin e lehtësuar vullnetar të viktimave të trafikimit me theks të veçantë në viktimat e trafikimit me Shqipërinë dhe së fundi edhe me Malin e Zi. Poashtu sa

i përket objektivave që ndërlidhen me përndjekjen e trafikuesve me njerëz, është funksionalizuar Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit (ILECU) në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila ka mandat bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Përkundër kufizimeve që Kosova ka në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar, agjencitë vendore për zbatim të ligjit janë duke identifikuar mundësitë për bashkëpunim operacional me organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë Evropiane për zbatim të ligjit, përderisa synim strategjik në kuadrin e përndjekjes së trafikuesve mbetet

## VII. Qasja e rekomanduar

Për të ndërtuar një qasje sa më koherente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit, duhet të merren parasysh vlerësimet e strategjisë së kaluar, rekomandimet e mekanizmave vlerësues ndërkombëtar, rekomandimet për aktivitetet që janë planifikuar në Strategjinë për crrënjosjen e trafikimit me njerëz 2012-2016. Në këtë mënyrë Qeveria e Kosovës, përkatësisht Autoriteti Nacional Kundër Trafikimit duhet të ketë parasysh për secilën objektivë ndërtimin e një bashkëpunimi të fuqishëm me të gjithë akterët vendor dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të parandalimit të trafikimit rekomandohet vazhdimi i fushatave vetëdijësuese, posaçërisht që synon grupet e margjinalizuara dhe komunitetet. Për më tepër, kërkohet që aktivitetet të cilat adresojnë trafikimin me njerëz shkojnë përtej ngritjes së vetëdijesimit si formë e parandalimit. Kjo mund të arrihet përmes fuqizimit të familjeve të cilat janë në rrezik për trafikim, në të cilat hyjnë familjet fëmijët e të cilave kanë lëshuar shkollën për të punuar si mënyrë e mbijetesës, familjet me prind të vetëm, minoritetet, etj.

Siç edhe është trajtuar përmes Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë 2015-2019, një mënyrë tjetër për fuqizimin e përpjekje për parandalimin e trafikimit është trajtimi sa më i madh i këtij fenomeni nga institucionet arsimore. Në këtë mënyrë rekomandohet që pasurimi i mëtutjeshëm i programeve arsimore me informata të nevojshme për parandalimin e trafikimit të bëhet sa më shpejt dhe zbatimi i këtyre programeve. Trajnimi i mësimdhënësve është gjithashtu një fushë tjetër me rëndësi të veçantë, në veçanti në lidhje me komunikimin sa më të mirë të informatave nga programet në fjale tek fëmijët. Shtimi i përpjekjeve dhe mundësive për përfshirjen e viktimave të trafikimit në arsimin e lartë, si një mënyrë për riintegrimin afatgjatë të tyre. Kjo mund të arrihet përmes mundësive të bursave të ndryshme nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në mënyrë që të ndërtohet një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin e trafikimit duhet të përkushtohet vëmendje gjithashtu në përfshirjen dhe lehtësimin e qasjes së grupeve të rrezikuara ndaj trafikimit në edukimin jo-formal.

Autoriteti Kombëtar dhe institucionet përgjegjëse duke u bazuar në përvojat ndërkombëtare, duhet konsiderojnë dhe intensifikojnë përpjekjet për trajtimin e identifikimit të pornografisë së fëmijëve dhe ndërmarrjen e masave për ndalimin këtij fenomeni. Në këtë kuadër vetëdijesimi i prindërve për shtimin e kontrollit prindor lidhur me shfrytëzimin e rrjeteve

sociale dhe internetit në përgjithësi nga ana e fëmijëve, si dhe të informohen lidhur me rrezikun e pornografisë së fëmijëve, trafikimit dhe rekrutimit përmes internetit.

Si një mjet tjetër që është treguar efikas në rastet tjera, duhet të zbatohen masa që kanë për qëllim uljen e kërkesës, për shërbimet seksuale dhe kërkesës së shfrytëzimit në punë. Për këtë duhet të shtohen përpjekjet dhe informimi lidhur me sanksionet ligjore që kanë të bëjnë me përfshirjen në trafikimin me njerëz si një formë për reduktimin e kërkesës.

Me qëllim të informimit dhe lehtësimit të qasjes të të gjithë akterëve të përfshirë, por edhe të qytetarëve lidhur me politikat dhe legjislacionin kundër trafikimit me njerëz, duhet të funksionalizohet sa më parë faqja zyrtare për punën e Autoritetit Kombëtarë.

Forma të tjera për të shtuar përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e trafikimit përfshijnë: mobilizimin e shoqërisë civile dhe komunitetit, në parandalim, identifikim dhe përkrahje për riintegrimin e viktimave të trafikimit; aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, vetëdijesimin dhe ngritjen e ndjenjës së përgjegjës të institucioneve të ndryshme (qeveritare dhe jo-qeveritare) ne identifikimin dhe raportimin e rasteve të dyshimta të trafikimit; fuqizimi i mëtutjeshëm i mekanizmave të referimit, nacionale dhe transnacionale; Shtimi i përpjekjeve për bashkëpunim më të mirë në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar; Integrimi i institucioneve të Kosovës në mekanizma ndërkombëtar që merren ekskluzivisht me trafikimin me njerëz; Përmirësimi menaxhimit dhe përpilimit të të dhënave që janë koherente ndërmjet të gjitha institucioneve të zbatimit të ligjit dhe kategorizimin e këtyre të dhënave sipas formës së trafikimit; Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende të tjera.

Një fushë tjetër shumë e rëndësishme që duhet të ketë prioritet në periudhën afatmesme është mbështetja e procesit të qëndrueshmërisë së strehimoreve dhe shërbimeve që ofrohen për viktimat e trafikimit. Gjithashtu, sigurimi i financimit për shërbimet e riintegrimit përbënë një fushë tjetër shumë të rëndësishme.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve në të gjitha shtyllat e çështjes së trafikimit me njerëz do të ketë trajtim të veçantë në këtë strategji. Për këtë rekomandohet që të shtohen përpjekjet për mundësimin e një koordinimi më të mirë ndërmjet të gjitha institucioneve të përfshira, qoftë në fushën e parandalimit, identifikimit apo mbrojtjes, ndjekjes penale, etj.

## VIII. Korniza Ligjore dhe Institucionale

### Korniza Ligjore Ndërkombëtare

Kjo strategji si dhe dokumentet përcjellëse janë hartuar duke respektuar një sërë dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare që kanë për synim mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Në dy dekadat e fundit, numri i instrumenteve rajonale dhe ndërkombëtare relevante për trafikim është shtuar dukshëm. Përderisa shumë instrumente ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, si dhe traktatet për bashkëpunim dhe reforma në sektorin e sigurisë përmbajnë nene relevante për trafikim, vetëm ato instrumente të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me trafikimin janë përfshirë në këtë analizë të kornizës ligjore.

Në kuadër të legjislacionit ndërkombëtar, Protokolli i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit në persona, me theks të veçantë të

femrave dhe fëmijë[9], i cili plotëson Konventën kundër krimit të organizuar transnacional[10], shënon instrumentin më gjithëpërfshirës të bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me trafikimin me njerëz në format moderne të tij. Përgjatë shekullit 19 dhe 20 janë zhvilluar një numër i madh i marrëveshjeve ndërkombëtare në drejtim të parandalimin dhe luftimit të shfrytëzimi të njerëzve. Përkundër faktit se shpesh synonin një kategori të kufizuar të personave, këto traktate kanë formësuar zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare në këtë fushë dhe shpjegojnë drejtimin të cilin ka marr Protokolli për Trafikim në Persona.

Krahas Protokollit në fjalë, e drejta ndërkombëtare përfshinë një numër instrumentesh ligjore ndërkombëtare të cilat identifikojnë, përkufizojnë dhe përshkruajnë format e ndryshme të shfrytëzimit, duke përfshirë të gjitha format që theksohen në Protokollin për Trafikim në Persona. Konventa për eliminimin e diskriminimit të të gjitha formave ndaj femrave kërkon nga shtetet të ndërmarr të gjitha masat e duhura për shtypjen e të gjitha formave të trafikimit ndaj femrave dhe shfrytëzimit të femrave për prostitucion.

## Instrumentet e Bashkimit Evropian

Trafikimi me njerëz, përbënë shkelje të të drejtave të njeriut, dhe kjo dukuri si e tillë prek grupe të margjinalizuar sikurse femrat dhe fëmijët në veçanti. Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva të qarta duke synuar mbrojtjen e këtyre grupeve dhe parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, posaçërisht përmes fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve të policisë dhe gjyqësorit të vendeve anëtare. Në këtë mënyrë, BE ka prezantuar një kornizë që përfshinë dispozita të përbashkëta në mënyrë që të trajtoj çështje të caktuara, sikurse kriminalizimi dhe dënimet ose rrethanat rënduese në raste të trafikimit me njerëz. Veprimet e BE-së bazohen në instrumentet që përcaktojnë objektivat dhe prioritetet e tij, por gjithashtu janë të integruara në një kontekst me të gjerë të mbrojtjes kundër dhunës, turizmit seksual dhe pornografisë së fëmijëve.

Direktiva e re e Bashkimit Evropian përcakton rregullativën për identifikimin dhe sanksionimin e krimeve të ndërlidhura me trafikimin me njerëz. Sipas kësaj direktive, veprat të cilat përbëjnë shkelje të rëndë në lidhje me trafikimin përfshijnë: rekrutimit, transporti, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, duke përfshirë shkëmbimin ose kontrollin mbi këta persona për qëllime të shfrytëzimit.

## Korniza ligjore vendore

Në raport me kornizën ligjore ndërkombëtare Kosova adreson çështjen e luftimit, dhe parandalimit si dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit në dy drejtime, përkatësisht përmes zbatimit të kritereve të BE-së dhe përafrimi i legjislacionit në këtë fushë dhe së dyti përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku të gjitha konventat ndërkombëtare hyjnë në fuqi me automatizëm. Konventat ndërkombëtare nuk janë ratifikuar specifikisht nga Kuvendi i Kosovës, por hyjnë në fuqi në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 22, faqe 6.

Qeveria e Kosovës përmes mekanizmave përkatës institucional dhe me mbështetje të partnerëve ndërkombëtar dhe sektorit joqeveritar vendor ka bërë përparim të dukshëm në aspektet e kundër-trafikimit. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale që kanë hyrë në fuqi

---

[9] Protokolli 2000

[10]

në Janar të vitit 2013 kanë ashpërsuar politikën ndëshkimore për trafikuesit, kanë penalizuar shfrytëzimin e shërbimeve të viktimave të trafikimit dhe kanë përfshirë lypjen e detyruar si vepër trafikimi.

Më tej, Kosova është ndër vendet e pakta që ka një ligj të veçantë për parandalim dhe luftim të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit i cili ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 2013 dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuara, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko-sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo kombësisë së tyre, përmes një qasje të bazuar në të drejta të njeriut dhe me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve.

## Mekanizmat Operacional

Përveç kornizës ligjore, institucionet qe merren drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimeve për viktima të trafikimit funksionojnë në bazë të mekanizmave operacional që janë fuqizuar me Ligjin e ri për parandalimin dhe luftimin e trafikimit në njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Këto dokumente janë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për viktimat e huaja dhe ato vendore (të rishikuara ne 2013) dhe Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit. Këto dy dokumente janë aprovuar dhe zbatohen në koordinim të plotë nga të gjithë akterët që merren me identifikimin, mbrojtjen, dhe referimin e viktimave të trafikimit me njerëz.

## Korniza Institucionale

